



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 nëntor 2020
Nr. ref.:RK 1643/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/19

Parashtrues

Dedë Bala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ac. nr. 4524/2018, të 24 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Dedë Bala nga Gjakova, i përfaqësuar nga Yll Xhiha, avokat në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, [Ac. nr. 4524/2018] të 24 majit 2019 me të cilin ishte refuzuar si e pa themeltë ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit [PPP.nr.127/2018] të 28 shtatorit 2018, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 16 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 29 korrik 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai plotësimin e formularit zyrtar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.
9. Më 29 korrik 2019 një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
10. Më 5 gusht 2019, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar në Gjykatë.
11. Më 25 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës përmes shkresës “*Propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë*” kërkoi caktimin e masës së

përkohshme për Urdhrin për Përmbarim [P.nr.721/18] të 14 gushtit 2018, deri në vendosjen meritore të rastit.

12. Më 3 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës përsëri përsëriti kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme.
13. Më 5 nëntor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës ishte palë në Gjykatë në rastin KI42/11 (i cili nuk ka ndërlidhje me rastin e tanishëm, rast që ndërlidhet me veprën penale shmangie nga tatimi) – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Komunale të Prishtinës P. nr. 2630/2006, Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ap. nr. 242/2007 dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 101/2010.
15. Më 13 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës kishte bërë marrëveshje me shkrim për hua-marrje me P.M (pala e interesuar), fillimisht duke i marrë shumën 200.000 EUR dhe më pas 69.370 EUR, pra në total shumën 269.370 EUR. Përderisa parashtruesi i kërkesës nuk e kishte kthyer borxhin e marrë, pala e interesuar kishte iniciuar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë.
16. Më 21 qershor 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktgjykimit [Civ. nr. 707/06] miratoi kërkesën e palës së interesuar P.M, ashtu që detyroi parashtruesin e kërkesës që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 269.370,00 €, me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë, në afat mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga 28 qershori 2005, e tutje e deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 610,60 €, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
17. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të lartcekur, të cilën më 23 korrik 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC.nr.229/13] e *konfirmon me disa ndryshime* në llogaritjen e çështjes së kamatës.
18. Më 14 gusht 2018, Përmbaruesi privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, nxori Urdhrin për Përmbarim [P.nr.721/18] për lejimin e përmbarimit në bazë të propozimit të kreditorit P.M (pala e interesuar), kundër parashtruesit të kërkesës, bazuar në dokumentin përmbarimor –Aktgjykimin [C.nr.707/06] të 21 qershorit 2012, të Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Aktgjykimin [Ac.nr.229/13] e 23 korrikut 2018, të Gjykatës së Apelit, lidhur me borxhin në vlerën 269.370 EUR.
19. Më 28 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti prapësim kundër Urdhrit për Përmbarim [P.nr.721/18] të 14 gushtit 2018, ndër të tjera duke theksuar se: (i) në propozim për përmbarim, shprehjet e përdorura, janë të pakuptimta dhe kundërthënëse dhe nuk janë në përputhshmëri me nenin 2 [Përkufizimet], veçanërisht me pikën 1.15 [Letra me vlerë] të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën

Përmbarimore; (ii) Urdhri për Përmbarim mbështetet vetëm në dokumentin përmbarimor: Aktgjykim i cili është fryt i provave të falsifikuara dhe të rreme, prova të sajuara me vepër penale, fakt për të cilin janë në zhvillim e sipër procedurat penale dhe civile pranë organeve kompetente; dhe se (iii) procedura përmbaruese ka filluar pa asnjë dokument të besueshëm por me dokumente – përkatësisht aktgjykimin, i cili është fryt i provave të falsifikuara dhe të rreme, prova të sajuara me vepra penale, e që janë në kundërshtim me Ligjin e Procedurës Përmbarimore.

20. Më 31 gusht 2018, pala e interesuar në cilësi të kreditorit paraqet përgjigje në prapësim duke theksuar që prapësimi i debitorit në tërësi është i pa rregullt dhe i pa bazuar, pasi që përmbarimi është lejuar në bazë të Titullit Përmbarimor - Aktgjykimit [C.nr.707/06] të 21 qershorit 2012, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, i cili ka marrë formën e prerë përmes Aktgjykimit [AC.nr.229/13] të 23 korrikut 2018, të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, me rastin e vendosjes nga përmbaruesi Privat kanë qenë të plotësuara të gjitha kushtet e parapara me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore.
21. Më 28 shtator 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, përmes Aktvendimit [PPP.nr. 127/18] refuzoi si të pa bazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim [P.nr. 721/18] të 14 gushtit 2018, të përmbaruesit privat Gjokë Radi. Në këtë Aktvendim, Gjykata Themelore ndër të tjera theksoi:

“Gjykata vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, [...] e sidomos duke pasur parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, debitori nuk ka ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetet pretendimet e tij, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së, sipas dispozitës të cekur është paraparë se provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim për ndryshe prapësimi do të refuzohet. [...]

Gjykata aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 par.1 të LPP-së, lidhur me nenin 21 dhe 22 par 1.1 të LPP ngase, dokumentet në bazë të cilit është lejuar përmbarimi janë dokumente të përmbarueshme (titulus executionis) dhe kanë tipare të përmbarueshmerisë dhe gjeti se pretendimet e prapësimit nuk hyjnë në shkaqet tjera të nenit 71 të LPP-së, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, andaj në kuptim të nenit 73.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij përmbarimi.”

22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur, për (i) shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, (ii) vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale; me propozim që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën si të bazuar, të anulojë në tërësi si të pabazuar aktvendimin e ankimuar; të ndalojë Urdhrin për përmbarim [P.nr.721/2018], të 14 gushtit 2018; si dhe të caktojë që procedura të vazhdojë në rivendosje pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë.

23. Më 24 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4524/2018] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.127/2018] e 28 gushtit 2018, të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

24. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit ndër të tjera theksoi si në vijim:

“Sa i përket pretendimeve ankimore të debitorit se në rastin konkret procedura është filluar pa asnjë dokument të besueshëm, kjo Gjykatë thekson se konform nenit 21 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm, e sipas nenit 22 pika 1 nën pika 1.1 lidhur me nenin 23 par. 1 të LPP-së, dokument përmbarues ndër të tjera është edhe vendimi gjyqësor, ashtu që në rastin konkret kemi të bëjmë me titull përmbarues siç është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, Civ.nr.707/2006, i datës 21.06.2012, i cili aktgjykim është dorëzuar në kopje të vërtetuar, konform dispozitës së nenit 36 par. 1 të LPP-së ku përcaktohet se "së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri", andaj një pretendim të tillë, Gjykata e Apelit e Kosovës nuk mund ta marrë si të bazuar.”

Procedura e filluar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë, dhe vendimi i Gjykatës së Apelit i 16 janarit 2020

25. Më 19 qershor 2019, sipas shkresave të lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës, kishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë që të eliminohen parregullsitë në lëndën [PP.nr. 127/2018].

26. Më 9 shtator 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [PPP.nr.127/2018] e hodhi si të palejuar kërkesën e debitorit, përkatësisht kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

27. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur, për (i) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore; (ii) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovojë në tërësi ankesën; të anulojë vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore duke refuzuar propozimin për përmbarim.

28. Më 16 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.5245/2019] të 16 janarit 2020, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.127/2018] e 9 shtatorit 2019 të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 102 [Parimet e

Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

30. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon që gjykata e Apelit nuk i trajtoi ankesat plotësuese të parashtruara më (1 nëntor 2018) dhe (10 dhjetor 2018) [*Shënim*: Këto ankesa plotësuese janë parashtruar pas kalimit të afatit 7 ditor për paraqitjen e ankesave, pasi që Aktvendimin lidhur me prapësimin parashtruesi e kishte pranuar me 9 tetor 2018], duke vendosur vetëm lidhur me ankesën kryesore, veprime këto që sipas parashtruesit tregojnë një gjykim jo të rregullt. Në vijim parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.127/18] të 28 shtatorit 2018, në arsyetimin e saj cek se debitori ka parashtruar prapësimin më 28 gusht 2018, ndërsa Gjyqtari ka vendosur pas 30 ditëve respektivisht me 28 shtator 2018, ndërsa mendimi juridik i Gjykatës Supreme [nr.217/2015] obligon gjykatat e rregullta të vendosin lidhur me prapësimin brenda 15 ditësh, për çka vlerësohet se kjo është një shkelje e dispozitave të procedurës.
31. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta do të duhej të bënin ndërprerjen e gjyimit sipas nenit 278.2 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore meqenëse ndaj të njëjtës çështje janë duke u zhvilluar procedura penale para organeve kompetente.
32. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson që Propozimi për përmbarrim i kreditorit P. M., i 14 gushtit 2018, nuk i përmban elementet e specifikuar në nenin 38 (Propozimi për Përmbarrim) i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, me çka nga propozimi mungojnë elementet nga neni 38 paragrafi 2 të LPP-së, për çka norma në fjalë: Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu propozon caktimin e masës së përkohshme nga ana e Gjykatës kundër Urdhrit për Përmbarrim [P.nr.721/18] të Përmbarruesit Gjokë Radi, me qëllimin e ruajtjes së gjendjes ekzistuese, deri në vendosjen meritore të çështjes.
34. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (I). Hedhet poshtë Propozimi për përmbarrim si i kundërligjshëm, ose të kthehet procedura në fazën fillestare meqenëse Propozimi nuk i përmban të gjitha elementet dhe nuk është në përputhje me ligjin, ankesat plotësuese nuk janë shtjelluar, dhe vendimmarrja lidhur me prapësimin ka ndodhur në kundërshti me mendimin juridik; (II) Të ia kumtoj vendimin parashtruesit të kërkesës dhe institucioneve relevante; (III) Ta publikoj vendimin në Gazetën Zyrtare; (IV) Vendimi të hyn në fuqi menjëherë.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në

proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 102

102.1 Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës.

102.2 Në qoftë se parashtresa e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë.

102.3 Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.

102.4 Në qoftë se parashtresat apo dokumentet që i bashkëngjiten nuk janë dorëzuar në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, gjykata do ta ftojë parashtruesin që brenda afatit të caktuar t'i paraqes ato. Po që se parashtruesi nuk vepron sipas këtij urdhri, gjykata do ta hedhë poshtë parashtresën e tij.

Neni 278

278.2 Gjukata mund ta caktojë ndërprerjen e gjykimit në qoftë se vendimi mbi kërkesëpadinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, kush është kryerësi dhe nëse ai është i përgjegjshëm, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose

eksperti ka dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë.

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 21

Bazat juridike për caktimin e përmbarimit

Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.

Neni 22

Dokumenti përmbarues

1. Dokumente përmbaruese janë:

- 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;*
- 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia);*
- 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;*
- 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;*
- 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës;*
- 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;*
- 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;*
- 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian;*
- 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.*

Neni 23

Vendimi dhe ujdia

1. Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.

2. Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktpajtim administrativ konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.

Neni 36

Vërtetimi për përmbareshmërinë

1. Së bashku me propozimin për përmbareshmëri, organi përmbareshmëri i dorëzohet edhe dokumenti përmbareshmëri, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareshmëris për përmbareshmëri.
2. Vërtetimin për përmbareshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë.
3. Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, dokumenti përmbareshmëri i noterit, në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përmbareshmëri, nuk ka nevojë të jetë i pajisur me vërtetimin për përmbareshmërin, por përmbareshmëria e tij përcaktohet sipas dispozitave të ligjit për noterin.
4. Vërtetimin për përmbareshmërin të dhënë pa qenë të plotësuar kushtet e parapara me ligj e anulon me aktvendim e njëjta Gjykata, respektivisht i njëjti organ i pushtetit sipas propozimit të debitorit. Propozimi për anulim duhet të paraqitet brenda afatit prej shtatë (7) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit përmbareshmëri tek debitori. Organi përmbareshmëri ose organi kompetent shtetëror po ashtu mund ta iniciojë anulimin në çdo kohë.

Neni 38

Propozimi për përmbareshmëri

1. Propozimi për përmbareshmëri duhet ta përmbajë kërkesën për përmbareshmëri në të cilën do të tregohet dokumenti përmbareshmëri origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbareshmëri, kërkuar i përmbareshmërit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbareshmëri, objekti i përmbareshmërit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbareshmërit.
2. Në rast se propozimi për përmbareshmëri nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbareshmëri do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.
3. Po qe se bashkë me propozimin për përmbareshmëri është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë organi përmbareshmëri do ta njoftojë kreditorin duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshoj apo plotësoj atë. Propozimi i ndryshuar dorëzohet brenda dhjetë ditëve pasi që organi përmbareshmëri të ia dërgojë kreditorit deklaratën e pasurive të debitorit. Megjithatë nëse kreditori kërkon aneks të deklaratës, siç përshkruhet në paragrafin 9 nenin 45 të këtij ligji, brenda afatit kohor të lejuar, koha e lejuar për përmbareshmëri të propozimit të ndryshuar për përmbareshmëri llogaritet nga data në të cilën shtojca e dorëzuar nga debitori i dërgohet kreditorit.

Neni 69

Prapësimi kundër vendimeve për përmbarim

1. Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbarues me të cilin përmbarimi është i lejuar.
2. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbarues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbarues është Gjykata.
3. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore, siç është përcaktuar me paragrafin 5. të nenit 5 të këtij ligji kur organin përmbarues është përmbaruesi privat.
4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.
5. Prapësimi kundër vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji.
6. Prapësimi do të përmbajë të dhënat e vendimit përmbarimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimit dhe nënshkrimin e debitorit.
7. Vendimi me të cilin refuzohet propozimi për përmbarim mund të goditet vetëm me ankesë të kreditorit të përmbarimit në pajtim me nenin 77 të këtij ligji.

Neni 71

Shkaqet e prapësimit

1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse:
 - 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë;
 - 1.2. dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;
 - 1.3. palët, përmes dokumentit publik ose dokumentit të certifikuar në pajtim me ligjin, të hartuar pas krijimit të dokumentit përmbarues, janë pajtuar që të mos e kërkojnë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë;
 - 1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi; 1.5. përmbarimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbarimit janë të kufizuara;
 - 1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit;
 - 1.7. kushti i përcaktuar në dokumentin përmbarues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj;
 - 1.8. kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;

1.9. realizimi i kredisë është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër, në mënyrë të përhershme ose për një periudhë të kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk mund ta bënte të njohur në procedurë në të cilën është nxjerr vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdje në Gjykatë ose në organin administrativ;

1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve;

1.11. Gjykata që ka marr vendimin për përmbarim nuk është kompetente;

1.12. përmbaruesi që ka lëshuar urdhrin për përmbarim nuk është kompetent.

Neni 73

Vendosja sipas prapësimit

1. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përfundimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata.

2. Vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm.

3. Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar.

LIGJI Nr. 05/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 12

1. Neni 73 i ligjit bazik, pas paragrafit 1., shtohet paragrafi i ri 1a., me tekstin si vijon:

1a. Gjykata vendos për prapësimin në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimi të prapësimit.

2. Neni 73 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet paragrafi i ri 4. me tekstin si në vijim:

4. Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të përcaktuara në Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4524/2018] të 24 majit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
39. Megjithatë, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin

që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2), në veçanti përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

40. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes neneve 24, 31 dhe 102 të Kushtetutës.
41. Megjithatë, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e dispozitave përkatëse të ligjit nga ana e Gjykatës Themelore dhe të Apelit (përkatësisht Ligjin për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore).
42. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kryesisht ankohet për interpretimin e dispozitave përkatëse të ligjeve materiale nga ana e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, si dhe rezultatin e procedurave para gjykatave të rregullta. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsistent se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë *"e shkallës së katërt"*, duke vënë në dyshim konstatimin e fakteve dhe interpretimet gjegjëse ligjore që janë bërë në procedura pranë gjykatave të rregullta. Gjykatat e rregullta janë në pozitën më të mirë për të bërë konstatimin e fakteve në rast dhe interpretimin dhe zbatimin e rregullave të së drejtës materiale dhe procedurale (shih përshtatshmërisht, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KI86/11, me parashtrues *Milaim Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 prillit 2012, paragrafi 33; si dhe rastet e bashkuara KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17, Parashtrues të kërkesës *Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 nëntorit 2017, paragrafët 46 dhe 47).
43. Në pajtim me qëndrimin e saj parimor, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërinë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat kushtetuese (kushtetutshmërinë). Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 37; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 57; KI154/17 dhe 05/18, parashtrues *Basri Deva, Afordita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 gushtit 2019, paragrafi 61, si dhe KI125/19 parashtrues *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 prillit 2020, paragrafi 45).
44. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka ofruar arsye të qarta dhe të mjaftueshme për gjetjet dhe konkluzionet e saj. Në Aktvendimin e kontestuar, Gjykata e Apelit sqaroi se *"Sa i përket pretendimeve ankimore të debitorit se në rastin konkret procedura është filluar pa asnjë dokument të besueshëm, kjo Gjykate thekson se konform nenit 21 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton"*

përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm, e sipas nenit 22 pika 1 nën pika 1.1 lidhur me nenin 23 par. 1 të LPP-së, dokument përmbarues ndër të tjera është edhe vendimi gjyqësor, ashtu që në rastin konkret kemi të bëjmë me titull përmbarues siç është aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, Civ.nr.707/2006, i datës 21.06.2012, i cili aktgjykim është dorëzuar në kopje të vërtetuar, konform dispozitës së nenit 36 par. 1 të LPP-së ku përcaktohet se "së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri", andaj një pretendim të tillë, Gjykata e Apelit e Kosovës nuk mund ta marrë si të bazuar."

45. *Për më tepër, lidhur me pretendimin për ndërprerjen e gjykimit meqenëse për të njëjtën çështje është duke u zhvilluar procedura penale, Gjykata e Apelit vuri në dukje se "Duke marrë parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat kryesisht konsistojnë në faktin se aktgjykimi i cili kërkohet të përmbarohet është fryt i provave të rreme dhe të falsifikuara dhe se i njëjti është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, Gjykata e shkallës së dytë konsideron se në këtë rast nuk ka të drejtë të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së aktit juridik, kështu që debitori pretendimet e lartcekura ankimore ka mundur t'i realizojë në procedurë tjetër."*
46. *Gjithashtu, Gjykata vëren se në Aktvendimin [Ac.nr.5245/2019] e 16 janarit 2020, përmes të cilit u vendos lidhur me kërkesën e parashtruesit për eliminimin e parregullsive, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar si në vijim: "Po ashtu, me shikimin në shkresat e lëndës, shihet se debitori ka qenë i njoftuar me gjithë rrjedhën e procedurës dhe me rregull i ka pranuar shkresat e dërguara nga gjykata, duke filluar nga propozimi për përmbarim bashkë me urdhrin për lejimin e përmbarimit, të cilin e ka pranuar me datë 22.08.2018, pastaj aktvendimin lidhur me prapësimin e ka pranuar me date 09.10.2018. ashtu që në rastin konkret, me paraqitjen e kërkesës për eliminimin e parregullsive me datë 24.06.2019, i njëjti e ka kaluar afatin ligjor për paraqitjen e kësaj kërkesë (ankese), siç përcakton neni 79 par. 1 i LPP-së, se "Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit ... në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar". Andaj, në kuptim të të lartcekurave kjo Gjykatë vlerësoi se ankesa e debitorit duhet të refuzohet si e pathemeltë, ndërsa aktvendimi i ankimuar duhet të vërtetohet."*
47. *Në vijim Gjykata vëren se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.127/18] kishte vendosur lidhur me prapësimin e parashtruesit të kërkesës brenda 30 ditëve, në suaza të afatit ligjor të cilin e përcakton Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Rrjedhimisht pretendimi i parashtruesit që kjo Gjykatë ka vendosur jashtë afatit të përcaktuar procedural është e pabazuar.*
48. *Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit, në vendimin e saj, arsyetoi në mënyrë të plotë dhe të hollësishme përfundimet e veta të parashtruara brenda afatit ligjor nga parashtruesi i kërkesës, duke ofruar një numër arsyesh në përgjigje të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata*

konsideron se kërkesa nuk dëshmon se procedurat pranë Gjykatës së Apelit dhe gjykatës së shkallës së parë kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur si rrjedhojë e interpretimeve të gabuara ligjore.

49. Në këtë drejtim, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë theksin në qëndrimin parimor se “*drejtësia*” që garanton neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substancial*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik dhe në parim, kjo shprehet para së gjithash përmes garantimit të një procedure kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 tetorit 2019, paragrafi 55).
50. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata Kushtetuese të vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil (Shih rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
51. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
52. Prandaj, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta, në ndonjë mënyrë, ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ.
53. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 24 dhe 102 të Kushtetutës.
54. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm që nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për “*gëzimin e të drejtave dhe lirive*” që garantohen me dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në

mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit e të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me “*gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*”. (Shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës KI16/19, me parashtrues *Bejta Commerce*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 nëntorit 2019, paragrafi 42; dhe KI67/16, me parashtruese *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).

55. Ndërsa, sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, respektivisht, Gjykata rithekson qëndrimin e saj sipas së cilit vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 52).
56. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

57. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej pagesa e shumës për të cilën detyrohej deri në vendosjen meritore të çështjes nga kjo Gjykatë.
58. Gjykata tani më konstatoi se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.
59. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa deklarohet e papranueshme (Shih në këtë kontekst rastin e Gjykates: KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 dhe 27 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2), 57 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi